



UNIVERSITETI I PRISHTINES
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush Ndrëtesa e Rektoratit, 1000 • Prishtinë, Republika e Kosovës Tel: +381 38 244
183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.:

673

Date:

06/05/2025

RAPORTI I VLERËSIMIT PËR DORËSHKRIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

Fakulteti	i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Komunikacion dhe Transport
Projektpropozimi	Analiza kritike e projektit infrastrukturor të zonës qendër (rruga Ibrahim Mazreku) në Malishevë
Kandidati	Bsc. Mustafë Krasniqi
Mentori	Prof.dr.sc. Sadullah Avdiu
Aprovimi i Projektpropozimit në Këshillin e fakultetit	Datë: 12.06.2023 Vendimi me nr.: 1012/2-14
Vlerësimi i dorëshkrimit: Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit, Nr. 1012/2-14 të datës 12.06.2023 dhe Vendimit Nr. 613 të datës 25.04.2025 për vazhdimin e afatit, është formuar Komisioni me këtë përbërje: <ol style="list-style-type: none">1. Prof.ass.dr. Ramadan Duraku, kryetar,2. Prof.dr.sc. Sadullah Avdiu, mentor.3. Prof.ass.dr. Gëzim Hoxha, anëtar, për vlerësimin e punimit Master me titull " <i>Analiza kritike e projektit infrastrukturor të zonës qendër (rruga Ibrahim Mazreku) në Malishevë</i> " (<i>Critical analyze of the infrastructural project for central zone (road Ibrahim Mazreku) in Malisheva</i>), të kandidatit Bsc. Mustafë Krasniqi. Pas kontrollimit të punimit të lartpërmendur Komisioni jep këtë: RAPORT Punimi me titull " <i>Analiza kritike e projektit infrastrukturor të zonës qendër (rruga Ibrahim Mazreku) në Malishevë</i> " (<i>Critical analyze of the infrastructural project for central zone (road Ibrahim Mazreku) in Malisheva</i>), është hartuar në 7 kapituj dhe është ilustruar përmes 46 figurave dhe 20 tabelave. Në kapitullin e parë është bërë një hyrje në problematikën e trafikut dhe të infrastrukturës rrugore në komunën e Malishevës. Janë identifikuar problemet me të cilat do të merret ky punim diplome. Në kapitullin e dytë është bërë përshkrimi i llojeve të kryqëzimeve (udhëkryqeve) në këtë zonë, dhe janë identifikuar problemet me të cilat përballen pjesëmarrësit në trafik. Janë shtjelluar pikëpamjet teorike si të formave të ndryshme të udhëkryqeve, me llojet e udhëkryqeve dhe me kriteret që duhet ti plotësojnë zgjidhjet të cilat janë përdorë në atë zonë. Në kapitullin e tretë është bërë studimi i jolinearitetit të qarkullimit të automjeteve për periudha të caktuara kohore (ditore, javore dhe mujore). Janë analizuar rezultatet e fituara nga matjet në terren dhe dhënë sugjerimet dhe propozimet për përmirësimin e gjendjes ekzistuese.	

Në kapitullin **e katër** është analizuar gjendja ekzistuese e udhëkryqeve përkatëse (U1 deri U4) dhe janë konstatuar problemet, edhe pas intervenimit nga ana e komunës së Malishevës, dhe janë dhënë propozimet përkatëse në bazë të përfundimeve të nxjerra nga analiza në terren.

Në kapitullin **e pestë** është përdorë softueri PTV Vissim për analizën e gjendjes së trafikut në zonën e udhëkryqeve të trajtuara. Me ndihmën e këtij softueri është trajtuar edhe problematika e jolinearitetit të qarkullimit të automjeteve në zonën e secilit udhëkryq.

Në kapitullin **e gjashtë** është bërë analiza e nivelit të shërbimit për [të gjitha udhëkryqet (U1 deri U4) dhe janë nxjerrë përfundimet përkatëse.

Në kapitullin **e shtatë** janë bërë propozimet përkatëse për problemet e evidentuara të të gjitha llojeve dhe natyrave.

Në kapitullin **e tetë** janë nxjerrë përfundimet dhe janë dhënë sugjerimet përkatëse për përmirësimet e mundshme në ndërhyrjet e ardhshme, me qëllim të tejkalimit sa më të mirë të situatave ekzistuese.




PËRFUNDIM

Në bazë të shqyrtimit të punimit Master, Komisioni për vlerësim konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i shtjelluar përmes figurave, tabelave dhe vizatimeve.

Prandaj, Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidatit Bsc. Mustafë Krasniqi, me titull "*Analiza kritike e projektit infrastrukturor të zonës qendër (rruga Ibrahim Mazreku) në Malishevë*" (*Critical analyze of the infrastructural project for central zone (road Ibrahim Mazreku) in Malisheva*), mendon se i plotëson të gjitha kriteret për punim Master, prandaj i propozon që të jepet në diskutim publik.

Prishtinë, 05.05.2025

Komisioni:

1. 
(Prof. dr. sc. Sadullah Avdiu, mentor)
2. 
(Prof. ass. dr. Ramadan Duraku, kryetar)
3. 
(Prof. ass. dr. Gezim Hoxha, anëtar)

P.S.: Numri i faqeve shtohet sipas nevojës. Vendi, data dhe nënshkrimet vijnë në fund.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE



**PUNIM DIPLOME
MASTER**

Mentori:

Prof.dr.sc. Sadullah Avdiu

Kandidati:

Bsc. Mustafë Krasniqi

Prishtinë, 2025

Abstrakti

Ky punim ka për qëllim analizën dhe vlerësimin e kushteve të infrastrukturës rrugore dhe të komunikacionit në segmentin rrugor "Ibrahim Mazreku" në qytetin e Malishevës, me fokus të veçantë në katër udhëkryqet kryesore: U1, U2, U3 dhe U4. Segmenti i përzgjedhur përbën një nga rrugët kryesore të lëvizjes urbane në qytet dhe ka qenë subjekt i ndërhyrjeve infrastrukturore të realizuara nga Komuna e Malishevës gjatë viteve të fundit. Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë dhe vlerësojë ndikimin e këtyre ndërhyrjeve në funksionalitetin e rrjetit rrugor, sigurinë rrugore dhe mobilitetin urban, duke përdorur qasje krahasimore dhe analiza vizuale e teknike.

Për realizimin e analizës janë përdorur ortofotot ajrore të viteve 2015, 2018 dhe 2025, të cilat ofrojnë një pasqyrë të qartë të ndryshimeve në infrastrukturë përgjatë dekadës së fundit. Përmes analizës krahasimore të këtyre imazheve është bërë evidentimi i gjendjes ekzistuese përpara dhe pas ndërhyrjeve, me theks në ndërtimin e rrethrotullimeve, zgjerimin e segmenteve rrugore, përmirësimin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, si dhe krijimin e trotuareve dhe korsive për biçikleta. Përveç kësaj, janë realizuar edhe skica teknike dhe plane gjeometrike të nyjeve përmes softuerit AutoCAD, me qëllim të dokumentimit të saktë dhe vizualizimit të ndryshimeve strukturore në rrjetin rrugor.

Në këtë studim janë analizuar problematikat e mëparshme si mungesa e infrastrukturës për këmbësorë, sinjalistika e pamjaftueshme, ngarkesa e lartë e trafikut në nyje dhe konflikti ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm në trafik. Për të vlerësuar më saktë efektin e ndërhyrjeve, është realizuar modelimi i rrjetit rrugor me ndihmën e softuerit PTV Vissim, i cili ka mundësuar simulimin e fluksit të trafikut dhe krahasimin e performancës së rrugës përpara dhe pas investimeve infrastrukturore.

Në përfundim, punimi ofron rekomandime për ndërhyrje të mëtejshme që synojnë zhvillimin e një infrastrukture rrugore të qëndrueshme dhe efikase, duke u mbështetur në parimet e planifikimit urban të integruar, zhvillimit të qëndrueshëm dhe sigurisë në trafik. Kjo qasje mund të shërbejë si model për analiza të ngjashme edhe në qytete të tjera të Kosovës që përballen me sfida të ngjashme në fushën e infrastrukturës dhe mobilitetit.

ABSTRACT

This paper aims to analyze and assess the conditions of the road infrastructure and traffic in the "Ibrahim Mazreku" road segment in the city of Malishevë, with a special focus on the four main intersections: U1, U2, U3, and U4. The selected segment constitutes one of the main urban traffic routes in the city and has been the subject of infrastructural interventions carried out by the Municipality of Malishevë in recent years. The goal of this study is to identify and evaluate the impact of these interventions on the functionality of the road network, road safety, and urban mobility, using a comparative approach and visual and technical analysis.

For the realization of the analysis, aerial orthophotos from the years 2015, 2018, and 2025 have been used, which provide a clear overview of the changes in infrastructure over the past decade. Through the comparative analysis of these images, the existing conditions before and after the interventions have been highlighted, with an emphasis on the construction of roundabouts, widening of road segments, improvement of horizontal and vertical signage, and the creation of sidewalks and bicycle lanes. Additionally, technical sketches and geometric plans of the intersections have been created using the AutoCAD software, for the accurate documentation and visualization of structural changes in the road network.

This study has analyzed previous issues such as the lack of pedestrian infrastructure, insufficient signage, high traffic congestion at intersections, and conflicts between different road users. To more accurately assess the effect of the interventions, road network modeling has been performed using the PTV Vissim software, which enabled traffic flow simulation and comparison of the road performance before and after the infrastructural investments.

In conclusion, the paper offers recommendations for further interventions aimed at the development of a sustainable and efficient road infrastructure, based on the principles of integrated urban planning, sustainable development, and traffic safety. This approach could serve as a model for similar analyses in other cities in Kosovo that face similar challenges in the fields of infrastructure and mobility